

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"KEA CENTER" SHPK.

Sot me datë 11/02/2021, une Ilirjana Dida, e bija e Naim dhe Nilke, lindur në fshatin Kishavec, Diber me 03/05/1991 dhe banues në Peshkopi, në lagjen "Nazmi Rushiti", mbajtës i pasaporte elektronike me nr. J15503002U, dhe nr. personal BF6606051, une Vullnet Dauti, i biri i Ramis dhe Ahmedie, lindur në fshatin Blliçe, me datë 03/06/1987 dhe banuese në Diber, në lagjen "Nazmi Rushiti", mbajtës i ID I70603077P dhe nr. personal 036824093. *Themelimin dhe për pasojë nënshkrimin e Aktit të Themelimit si më poshtë, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, dhe i bashkëlidhet në formë Shtojce Nr.1.*

NENI 1

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **"KEA CENTER" SHPK.**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim - marrës.
2. Administratori, për drejtimin e politikave financiare të shoqërisë dhe marrëdhëniet me të tretët.

NENI 2

EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë është **" KEA CENTER " SHPK.**

NENI 3

SELIA

- 2.1 Selia e shoqërisë **" KEA CENTER " SHPK** është në adresën: **Bashkia Diber/Peshkopi , lagjia "Nazmi Rushtiti", rruga Nazmi Rushiti", hyrja 255, Diber.**

NENI 4

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë me **afat të pacaktuar.**

NENI 5

OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme:



Shoqëria ka për Objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda Ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në: fushen e arsimit dhe zhvillimi i veprimtarive të ndryshme me karakter edukues dhe argetues për fëmijë.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) LEK.

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2(dy) Kuota të vetme, ku njëra kuotë në vlerën 5000 (pese mije) LEK.

NENI 7

KONTRIBUTET

Kontributi në kapitalin e shoqërisë ofrohet nga znj Ilirjana Dida dhe z.Vullnet Dauti, në cilësinë e ortakëve, Ky kapital është formuar nga themeluesit e shoqërisë, duke kontribuar ne para per 100 % te vleres se plote te kapitalit themeltar te shoqerise, nëpërmjet depozitimit pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër, konkretisht: Znj.Ilirjana Dida në vlerën 5000(pese mije) Lek dhe zotëruar 50 % të Kuotave, pra 1 (nje) KUOTE te vetme dhe z. Vullnet Dauti ne vleren 5000 (pese mije) Lek, duke zoteruar 50 % te Kuotave pra 1 (nje) KUOTE te) dhe të dy së bashku 100 % të Kuotave.

NENI 8

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat i transferohen të tretëve sipas mënyrave të parashikuara në statut.

NENI 9

ADMINISTRIMI

Shoqëria mund të administrohet nga një administrator i vetëm ose nga disa administratorë. Administratori/ët do të ushtrojë/në të gjitha kompetencat në përputhje me nenin 95 të ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, Statutit, dhe/ose Aktit të emërimit.

Me këtë Akt emërohet Administrator i vetëm i shoqërisë zj.Ilirjana Dida

Administratori i vetëm i emëruar në bazë të këtij akti do të ketë të gjitha kompetencat që parashikohen për administratorët në këtë akt themelimi dhe statutin e shoqërisë.

Administratori do të ketë këto kompetenca:

Kompetenca të përgjithshme përfaqësimi:


- Kompetenca për të përfaqësuar shoqërinë duke kryer çdo akt të konsideruar si i nevojshëm në interes të vetë shoqërisë,
- Kompetencë për të nënshkruar të gjitha korrespondencën, faturat e lëshuara nga shoqëria dhe mandatet bankare, të pranojë, xhirojë, arkëtojë dhe lëshojë vërtetime për pagesat, kambialet;
- Kompetencë për të paraqitur kërkesa, rekurse dhe ankime, të përfaqësojë shoqërinë para çdo autoriteti gjyqësor dhe administrativ, kombëtar apo të huaj, si palë paditëse apo e paditur, të natyrës fiskale apo tregtare si dhe të çdo natyre tjetër, në çdo shkallë dhe gradë, edhe në gjykimet në apel, gjykatën e lartë, kompetencë për të proceduar me tituj ekzekutiv, të kujdeset për revokimin, kompetencën për të ndërhyrë dhe kërkuar kreditë në procedura falimentimi dhe të paraqesë deklaratat përkatëse, të emërojë avokatë, përfaqësues të posaçëm në gjykime dhe ekspertë, të kryejë transaksione, të emërojë arbitra dhe ndërmjetës dhe të nënshkruaj aktet përkatëse të zgjidhjes miqësore të mosmarrveshjeve;
- Të përfaqësojë shoqërinë para çdo autoriteti qeverisës, rajonal dhe komunal, para administratave të varësisë dhe enteve të tjera, duke paraqitur kërkesa, ankime, rekurse e denoncime të çdo lloji, si dhe për të siguruar lëshimin e liçensave dhe autorizimeve të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë dhe për çdo aktivitet tjetër të përshtatshëm.

Kompetenca Administrative:

- Të përfaqësojë shoqërinë para çdo autoriteti të sigurisë publike, me të drejtën për të bërë deklaratat, denoncime dhe ankime që do të jenë të nevojshme.
- Kompetencë për të kryer çdo operacion për vendosjen e kufizimeve, heqjen e kufizimeve, dorëzimin, tërheqjen dhe sigurimin e mallrave me të gjitha zyrat, shoqëritë, ndërmarrjet publike dhe private të transportit etj., si dhe para administratave doganore, kombëtare e të huaja.
- Kompetenca për të marrë përsipër detyrime për llogari të shoqërisë, për të kërkuar pagesën e kredive të çdo lloji, të marrë pagesa, mandate, parapagime, urdhra postar, çeqe të çdo lloji, depozita garancie nga bankat dhe institute të tjera të kreditit dhe nga zyrat postare e telegrafike dhe nga çdo zyrë tjetër apo ent publik apo privat, duke lëshuar vërtetim të vlefshëm.
- Të marrë pjesë në gara dhe tender të organizuara nga administrata publike, nga ente publike apo private dhe nga të tretë, për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve etj., dhe të paraqesë ofertat përkatëse.

Kompetencat në lidhje me institucionet bankare dhe financiare:

- Kompetenca për të firmosur xhirimin e çeqeve të llogarive rrjedhëse bankare, çeqeve të xhirueshme, urdhrave kambiale dhe postarë, për kreditimin e llogarive rrjedhëse të regjistruara në emër të shoqërisë.
- Të marrë pagesa nëpërmjet çeqeve jo të transferueshme të regjistruara në emër të shoqërisë.
- Të kryejë para çdo enti tjetër publik apo privat operacione të tërheqjes apo heqjes së kufizimeve mbi shumat dhe vlerat, urdhrave, dokumenteve dhe korrespondencës, duke lëshuar faturë të plotë dhe formale si dhe operacione depozitimi dhe çdo aktivitet tjetër në fushën e sipërcituar, në atë gjyqësore , fiskale dhe kontabël si dhe në atë të privacy-së dhe sigurisë në punë.

NENI 10

Shpenzimet e nevojshme deri në themelimin e shoqërisë janë në ngarkim të shoqërisë, e cila me regjistrimin e saj i merr përsipër këto shpenzime si detyrime të saj.

NENI 11

Mosmarrveshjet që mund të lindin midis palëve brënda dhe jashtë shoqërisë, zgjidhen nga gjykata kompetente shqiptare, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Për sa nuk është shprehur në këtë Akt Themelimi, shoqëria i referohet çdo ligji të veçantë përkatës që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 13

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Autorizohet zj. Ilirjana Dida për të ndjekur procedurat ligjore duke përfaqësuar shoqërinë "KEA CENTER" shpk., me administrator zj. Ilirjana Dida pranë QKB si dhe pranë çdo institucioni tjetër publik, shtetëror, apo institucion privat ku shoqëria ka interesa të drejtpërdrejta.

NENI 14

GJUHA

Ky akt themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe.

ORTAKËT:

ILIRJANA DIDA

ILIRJANA DIDA



VULLNET DAUTI

VULLNET DAUTI

